



Planuar / Dorezuar Primijeno/Prodato Received/Delivery	12.12.2022	2	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRISHAK	7949	2022	114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.922/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtsitë, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.922/2022 të datës 14.10.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

kundër organit të punësimit Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike "Masë Disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET ankesa Anr.922/2022 e datës 14.10.2022, e parashtruar nga ankuesja

dhe anulohet Vendimi i Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Shëndetësisë me nr. protokoll 05-4525 i datës 12.09.2022 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë-Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë.

II.OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Komisioni Disiplinor që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 dite sipas pikës 1 nga dita e pranimit të tij.

A r s y e t i m

Ndaj ankuseses sipas shkresave të lëndës e punësuar në pozitën "Zyrtare Profesionale për Tuberkuloz" në Divizionin për Shërbime të Veçanta Departamenti i Shërbimeve Shëndetësore në Ministrinë e Shëndetësisë, më datën 12.09.2022 me nr. protokoll 05-4525 Komisioni Disiplinor i Ministrinë së Shëndetësisë ka nxjerr vendim me të cilin vendim ankuseses i ka i shqiptuar masa disiplinore "ndalim i 30% të pagës për një periudhë për (4) muaj".

Ankuesja e pakënaqur me vendimin e datës 12.09.2022 me nr. protokoli 05-4525, të Komisionit Disiplinor të Ministrinë së Shëndetësisë Komisionit, me datë 14.10.2022, me numër protokoli 6207/2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovë, me pretendimin ankimor kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Shëndetësisë me nr. protokoli 05-4525 të datës 12.09.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 31.10.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa Këshilli më datë 09.11.2022, me numër protokoli 6990/2022, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Shëndetësisë, me shkresat e bashkangjitura.

Për shkak të specifikave të lëndës, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 29.11.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.175/2022 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankueses për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokoli 6207/2022 të datës 14.10.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i Komisionit Disiplinor në Ministrinë e Shëndetësisë me nr. protokoli 05-4525 i datës 12.09.2022; Kolegji nuk ka trajtuar provat tjera të bashkëngjitura për shkak se vendimi ka pasur të meta të tilla që nuk ka mundur të shqyrtohet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoj se ekziston baza ligjore që çështjen ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja në bazë të akt emërimit të datës 17.09.2012, është e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë në pozitën "Zyrtar i Kualitetit dhe Kontrollit", e njëjta sipas vendimit me nr. protokoli 05-2930 të Sekretarit të Përgjithshëm është caktuar sipas pikës dy të vendimit në pozitën "Zyrtare Profesionale - Koordinator i Programit Kombëtar të Kontrollit të Tuberkulozit" (PKKT) dhe me datë 12.09.2022 me nr. protokoli 05-4525 Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Shëndetësisë i ka shqiptuar masë disiplinore lidhur me furnizimin me barëra antituberkulare, sepse ka dështuar që të ketë planifikim dhe furnizim të mirëfilltë me barëra për pacientët e kësaj natyre.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka analizuar vendimin e komisionit disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë me nr. protokoli 05-4525 i datës 12.09.2022 dhe ka konstatuar se, Komisioni disiplinor ka inicuar procedurën disiplinore ndaj ankueses në bazë të shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të MSH nr.05-3996 të datë 12.08.2022.

Lidhur me vendimin e komisionit disiplinor Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht nenin 25 ku përcaktohet se " Detyrimi i respektimit të ligjit, mbrojtjes të interesit të shtetit dhe të drejtave të njeriut 1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë

Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike", prandaj nisur nga dispozitat e lartshënuara Kolegji konstaton se komisioni disiplinor i MSH nuk ka arritur të përcaktoj saktë se cilën shkelje e ka bërë ankuesja dhe nuk ka dhënë një përshkrim të saktë të dispozitave ligjore të cilat ankuesja me veprimet dhe mos veprimet e saj ka ra ndeshë më dispozitat ligjore në fuqi.

Ndërlidhur më këtë Kolegji ka pasur parasysh edhe neni 46 paragrafi 1, 3 dhe nën paragrafin 3.1, 3.2, 3.3, 3.4 Shkeljet disiplinore 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore, 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës".

Kolegji ka konstatuar se Komisioni disiplinor i MSH ka dështuar ta sqaroj në mënyrë të drejtë gjendjen faktike dhe ligjore ndaj ankuseses, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm të shkeljes nga ana e ankuese pa marrë për bazë përshkrimin e detyrave të punës, pa sqaruar se cilat detyra nuk janë kryer në kohë, cilat kanë qenë pasojat e shkaktuara nga veprimi apo mos veprimi i ankuseses, dëmtimin e bugjetit nëse ka pasur si pasojë e shkeljes së ankuseses dhe pasojave tjera të shkaktuara ndaj institucionit dhe publikut.

Komisioni disiplinor ka bërë një përshkrim të përgjithshëm citoj " duke pasur parasysh faktet dhe dëshmitë, ka konstatuar se njësia përgjegjëse dhe zyrtari përgjegjës për koordinimin e punëve lidhur me furnizimin me barrna antituberkulare ka dështuar që të ketë planifikim dhe furnizim..."

Ndërlidhur me këtë Kolegji ka konstatuar se arsyetimi i vendimit të komisionit disiplinor është në kundërshtim me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht nenin 48 Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim 1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij; si dhe me nenin 52 Paligjshmëria e aktit administrativ 1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material.

Andaj, pas administrimit të provave të lëndës dhe rrjedhimisht konstatimeve të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet ankimore te ankueses janë të bazuara dhe se janë plotësuar kushtet ligjore që lënda e ankueses të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje në mënyrë që organi i shkallës së parë t'i eliminojë vërejtjet e cekura duke marr parasysh pikëpamjet juridike të dhëna në këtë vendim.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.NR.922/2022**

Çlirim ZEKA



Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.